

URDHËR
Nr. 200, datë 3.3.2025

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË
MJEDISËT E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe të tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Shijak;
- Njesisë Administrative Xhavzotaj;
- Njesisë Administrative Gjepalaj;
- Njesisë Administrative Katund i Ri;
- Njesisë Administrative Maminas;
- Njesisë Administrative Manzë;
- Njësive administrative të qytetit të Durrësit.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Shijak;
- Njesisë Administrative Xhavzotaj;
- Njesisë Administrative Gjepalaj;
- Njesisë Administrative Katund i Ri;
- Njesisë Administrative Maminas;
- Njesisë Administrative Manzë;
- Njësive administrative të qytetit të Durrësit.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të urdhrit nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influencës Aviare”, vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thetore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj sëmundjes së influencës aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e:

- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Shijak;
- Njesisë Administrative Xhavzotaj;
- Njesisë Administrative Gjepalaj;
- Njesisë Administrative Katund i Ri;
- Njesisë Administrative Maminas;
- Njesisë Administrative Manzë;
- Njësive administrative të qytetit të Durrësit.

4. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të shpendëve të egër, veçanërisht ato të ujit, si dhe monitorimin e mëtejshëm për zogj të ngordhur ose të sëmurë në territorin e:

- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Shijak;

- Njesisë Administrative Xhavzotaj;
- Njesisë Administrative Gjepalaj;
- Njesisë Administrative Katund i Ri;
- Njesisë Administrative Maminas;
- Njesisë Administrative Manzë;
- Njësive administrative të qytetit të Durrësit.

5. Ky urdhër zbatohet në përputhje me:

- Urdhrin nr. 117, datë 19.3.2022, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë”;
- Urdhrin nr. 411, datë 20.9.2022, “Për miratimin e planit të kontigjencës për sëmundjen e influencës aviare”;
- Urdhrin nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e programit kombëtar të mbikëqyrjes së influencës aviare”;
- Urdhrin nr. 235, datë 27.7.2009, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e biosigurisë ndaj gripit të shpendëve të shkaktuar nga nëntipi H5N1, në zogjtë e egër, në shpendët, pulat e stabilimenteve të shpendarisë’”;
- Urdhrin nr. 236, datë 27.7.2009, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi disa masa mbi mbrojtjen ndaj gripit të pulave, shkaktuar nga nëntipi H5N1 te zogjtë e egër’”.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj